



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica  
Drejtori për Punë të Përgjithshme Administrative  
Uprava za Opšte, Administrativne i Posredničke Poslove  
01 Nr./Br.: 413101-28030  
Data/Datum 09.12.2022  
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SARANDE**



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KOMUNA GJAKOVË**

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI**  
**KOMUNAL NDËRKOMBËTAR**

**NDËRMJET**

**BASHKISË SARANDE**

dhe

**KOMUNËS GJAKOVË**

me synim

**NXITJEN E BASHKËPUNIMIT DYPALËSH NË FUSHËN E ADMINISTRATËS**  
**PUBLIKE, EKONOMISË, KULTURËS, ARSIMIT DHE TURIZMIT**

Kjo marrëveshje nënshkruhet nga Bashkia Sarandë (më tej “Bashkia”) dhe Komuna Gjakovë (më tej “Komuna”), këtu e tutje të referuara së bashku si “Palët”.

Duke qenë se Palët:

*Vlerësojnë* rëndësinë e promovimit të territorit, përmes zhvillimit të aktiviteteve në fushën e administratës publike, ekonomisë, kulturës, arsimit dhe turizmit.

*Marrin në konsideratë* historinë e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit ndër viteve ndërmjet Sarandës dhe Gjakovës në fusha të ndryshme të veprimtarive ekonomike, jetës artistike kulturore, turizmit dhe sportit.

*Synojnë* forcimin e bashkëpunimit ndërmjet qyteteve me interes të përbashkët në fushën e administratës publike, ekonomisë, kulturës, arsimit dhe turizmit.

*Konfirmojnë angazhimin* institucional për të bashkëpunuar në fusha me interes të përbashkët për të rritur efektivitetin e përpjekjeve të tyre zhvillimore.

*Duke ju referuar* Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040 neni 17 (k) dhe 30, Ligji për Bashkëpunimin Ndërkomunal Nr. 04/L-010, Ligji për Arbitrazhin Nr. 02/L-75

Kështu që, Palët shprehin synimin e tyre për të bashkëpunuar si në vijim:

## **Neni I Qëllimi**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje bashkëpunimi është të sigurojë një mënyrë bashkëveprimi dhe të lehtësojë bashkëpunimin midis Palëve, mbi baza jo-përtjashtuese, në fusha me interes të përbashkët, në fushën administratës publike, ekonomisë, kulturës, arsimit dhe turizmit.

## **Neni II Fushat e bashkëpunimit**

2.1 Palët bien dakord të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme të veprimit:

- a. Promovimi i aktiviteteve social ekonomike dhe turizmit;
- b. Shkëmbimi i përvojave profesionale në administratën publike lokale;
- c. Mbrojtja e mjedisit dhe ruajtja e burimeve natyrore dhe biodiversitetit;
- d. Bashkëpunim në hartimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta;
- e. Përmirësimi i trashëgimisë kulturore dhe sportit;
- f. Promovimi dhe zhvillimi i aktiviteteve edukative ndërkulturore dhe projekteve të të rinjve dhe studentëve të Sarandës dhe Gjakovës;
- g. Promovimi i aktiviteteve të parashikuara në këtë Marrëveshje;
- h. Takime të përbashkëta për të trajtuar çështje me interes të përbashkët.

**Neni III**  
**Konsultimi dhe shkëmbimi i informacionit**

- 3.1 Palët, të mbështetura në parimet bazë, do të mbajnë të informuar njëra-tjetrën dhe do të konsultohen për çështjet me interes të përbashkët, të cilat ka të ngjarë të çojnë në bashkëpunim të ndërsjellë.
- 3.2 Konsultimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe dokumenteve sipas këtij Neni do të jetë pa cënuar marrëveshjen, duke ruajtur karakterin konfidencial dhe të kufizuar të informacionit dhe dokumenteve të caktuara.
- 3.3 Palët, në kohë të ndryshme sipas nevojës, mund të kërkojnë për t'u mbledhur për të shqyrtuar mbarëvajtjen e aktiviteteve të zhvilluara sipas këtij Memorandumi dhe për të planifikuar aktivitetet e ardhshme.

**Neni IV**  
**Zbatimi i Marrëveshjes**

- 4.1 Kjo marrëveshje pasqyron pikëpamjet dhe synimet e Palëve për të bashkëpunuar në baza jo ekskluzive, të shprehura në mirëbesim, por pa krijimin e ndonjë detyrimi ligjor ose kryerjen e ndonjë përgjegjësie nga ana e ndonjërës prej tyre.
- 4.2 Kjo marrëveshje nuk do të kufizojë të drejtën, ose nuk do t'i pengojë Palët të hyjnë në memorandume ose angazhime me palët e tjera në lidhje me ndonjë aktivitet, projekt ose fushë bashkëpunimi të mbuluar nga ky Memorandum.
- 4.3 Palët do të jetë përgjegjëse për veprimet dhe lëshimet në lidhje me këtë marrëveshje dhe zbatimin e tij.
- 4.4 Marrëveshja e bashkëpunimit do të kryhet në përputhje me ligjet në fuqi të të dyja vendeve në bazë të detyrimeve përkatëse që merren nga të dy palët sipas të drejtës ndërkombëtare.
- 4.5 Marrëveshjet e lidhura nga komunat në kuadër të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar janë vetëm të natyrës administrative dhe teknike.
- 4.6 Në kuadër të këtij bashkëpunimit komunal ndërkombëtar, komunat nuk kanë të drejtë të heqin dorë nga kompetencat e tyre të përcaktuara me ligj, t'ia delegojnë një komune ose autoriteti publik të huaj ushtrimin e kompetencave të veta si dhe t'ia lejojnë komunës ose autoritetit publik të huaj ushtrimin e çfarëdo pushteti ekzekutiv, administrativ, legjislativ në territoret e të dy shteteve ose që synon të ketë efekt të tillë në territoret e të dy shteteve.

**Neni V**  
**Burimet Financiare për Realizimin e Bashkëpunimit**

Të dy palët pajtohen se çdo aktivitet që synon zbatimin e kësaj Marrëveshje nuk do të implikon pagesa shtesë nga sistemi publik financave, duke u bazuar në ligjin për financa publike në fuqi, por do të mbulohen nga institucionet e propozuara.

**Neni VI**  
**Koordinimi Ndërmjet Palëve**

Palët në këtë marrëveshje bien dakord për të formuar një grup të përbashkët, i cili është përgjegjës për zbatimin e marrëveshjes në fjalë.

**Neni VII**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

7.1 Çdo mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ose zbatimin e këtij memorandumi zgjidhet me mirëkuptim mes palëve.

7.2 Palët kanë të drejtë të bëjnë ndryshime në Marrëveshje me pëlqimin e ndërsjellët të tyre.

**Neni VIII**  
**Dispozitat Përfundimtare**

8.1 Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe do të qëndroj për një periudhë 10 (dhjetë) vjeçare.

8.2 Kjo marrëveshje mund të plotësohet, ndryshohet dhe shkëputet me pajtim të palëve përmes komunikimit të shkruar. Amandamentimi do jetë pjesë integrale e marrëveshjes pas nënshkrimit.


8.3 Kjo marrëveshje është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale, secila në gjuhën Shqipe ku palët nënshkruese marrin nga 1 (një) kopje.

**SI DËSHMI E KËSAJ**, përfaqësuesit e autorizuar të Palëve nënshkruajnë më poshtë:

PËR BASHKINË E SARANDËS  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Adrian Gurma**

Kryetar i Sarandës



PËR KOMUNËN E GJAKOVËS  
REPUBLIKA E KOSOVËS

**Ardian Gjini**

Kryetar i Gjakovës





BASHKIA SARANDË



KOMUNA GJAKOVË

# MARRËVESHJE MIQËSIE DHE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET  
BASHKISË SË SARANDËS, REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHE  
KOMUNËS SË GJAKOVËS, REPUBLIKA E KOSOVËS

Në frymën e respektit reciprok ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës  
Sot Kryetari i Bashkisë së Sarandës dhe Kryetari i Komunës së Gjakovës

**Z. Adrian Gurma dhe Z. Ardian Gjini**

Nënshkruajnë, nëpërmjet këtij akti zyrtar:

## BINJAKËZIMIN E SARANDËS DHE GJAKOVËS

Mbështetur në ndjenjat e vëllazërisë e miqësisë, për t'i shërbyer afrimit edhe më shumë, përparimit dhe bashkëpunimit të ngushtë midis Shqipërisë dhe Kosovës.  
Duke bashkuar forcat tona në një përpjekje të përbashkët bashkëpunimi në fushën e kulturës, arsimit, sportit, ekologjisë, ekonomisë dhe turizmit  
Do të punojmë për zhvillimin e përparimin e komuniteteve tona.

Më 28 nëntor 2022

Adrian Gurma

KRYETARI I BASHKISË



Ardian Gjini

KRYETARI I KOMUNËS

